



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Koncesionet/Partneriteti Publik Privat (PPP) në Shqipëri- Arritjet dhe Sfidat

Silvia Paskali

Përgjegjës, Sektori i Procedurave Koncesionare

Drejtoria e Koncesioneve

Koncesionet dhe Partneriteti Publik-Privat (PPP) në Republikën e Shqipërisë

Kuadri Ligjor i Koncesioneve/PPP

1. Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” (ndryshuar me ligjin nr.50, datë 18/07/2019).


✓ Ky ligj ka si qëllim krijimin e një kuadri të favorshëm dhe të qëndrueshëm për nxitjen, thithjen dhe krijimin e lehtësive për investimet që realizohen si koncesione/PPP.

2. VKM nr. 575, datë 07/10/2013 “Për aprovimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/PPP”,(ndryshuar me VKM nr.420, datë 20/05/2020).

Ne keto akte jane parashikuar te gjitha veprimet e dhenies me koncesion/PPP, qe nga identifikimi I projektit, hartimi i studimit te fizibilitetit , procedura konkurruese dhe deri te lidhja e kontrates.

Aktoret e perfshire ne proces jane Ministrite e Linjes dhe Njesite e Qeverisjes Vendore te cilet ne bashkepunim me Atrako-n kryejne te gjitha veprimet per dhenien e kontrates se koncesionit, ndersa MFE ben vleresimin e projekteve ne kendveshtrim te implikimeve buxhetore.

Kuadri Institucional i Koncesioneve/PPP



Të dhëna mbi ecurinë e kontratave koncesionare/PPP në Shqipëri




Figura 1: Numri dhe vlera totale e investimit (në lekë) të projekteve Koncesionare/PPP aktive sipas sektorëve, 2020

- ▶ Numri total i kontratave koncesionare/PPP është **224 (31% e PBB-së për 2019)**
- ▶ **14** Kontrata koncesionare/PPP janë me mbështetje buxhetore.
- ▶ **12.6 %** e kontratave koncesionare/PPP të miratuara janë propozime të kërkuara nga autoritetet kontraktuese, ndërsa **88.2 %** janë propozime të pakërkuara.
- ▶ **83%** e kontratave koncesionare janë në sektorin e Energjisë.

Koncesionet/PPP, aplikimi në sektorin e Strehimit

- ▶ Ligji nr. 125/2013 “*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*” (ndryshuar me ligjin nr.50, datë 18/07/2019), në nënin 4 ‘Fusha e zbatimit të koncesioneve/PPP’, përcakton se koncesionet/PPP mund të jepen për realizimin e punimeve dhe/ ose ofrimin e shërbimeve për sektorët dhe qëllimet e mëposhtme: *pika ‘j’ : ‘Strehim’*
- ▶ **Ndërtimi i banesave në kuadrin e PPP duhet të bazohet në parimet e mëposhtme:**
 - a) Alokimi i risqeve tek pala më e aftë për ti menaxhuar ato
 - b) Vlera më e mirë e parasë
- ▶ **Sipas nenit 52, të ligjit nr.52/2018 “*Për strehimin social*” marrëveshja për ndërtimin e banesave, që kryhet nga subjekte private, nëpërmjet PPP-ve, bazohet në një nga format e mëposhtme:**
 - a) Financimi i ndërtimit nga subjekti privat në truallin në pronësi të Nj.Q.V-së, në këmbim të përfitimit nga kjo e fundit një përqindje të caktuar sipërfaqe ndërtimi.
 - b) Financimi i ndërtimit nga subjekti privat dhe shfrytëzimi si banesa sociale me qira për një periudhe kohe të përcaktuar në marrëveshje midis financuesit dhe Nj.Q.V-së . Për ndërtimin e banesave në zonat e zhvilluara me qëllim strehimin, të cilat do të realizohen sipas kësaj forme, kushtet e përgjithshme të marrëveshjes midis palës publike dhe asaj private, përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për koncesionet/partneritetin publik privat. Referuar kësaj pike, projektet propozohen vetëm në formën e propozimeve të kërkuara.
 - c) Bashkëfinancim i ndërtimit nga subjekti privat dhe Nj.Q.V-së nga buxheti i vet dhe/ose me mbështetje të buxhetit të shtetit, përkundrejt përfitimit të një numri banesash sociale dhe ose me kosto të ulët.

Impakti dhe sfidat e përdorimit të koncesioneve/PPP në Shqipëri

► Impakti

- Ofrimi i punimeve dhe shërbimeve më cilësore
- Implementimi teknologjive dhe njohurive të reja në përputhje me standartet ndërkombëtare nga ana e palës private
- Menaxhim më të mirë të mbetjeve në përputhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm
- Mbrojtja e shëndetit të individëve përmes projekteve në fushën e shëndetësisë.

► Sfidat

- Alokimi në mënyrë efektive i riskut nëpërmjet alokimit tek pala më e aftë për ta menaxhuar, me qëllim minimizimin e materializimit të kostove të fshehura të projektit, si dhe maksimizimin e vlerës së parasë.
- Adresimi i kufizimeve të përballueshmërisë dhe administrimi i risqeve fiskale afatgjata
- Sigurimi i transparencës dhe llogaridhënies (*Procesi i monitorimit të të gjithë kontratave koncesionare/PPP në Republikën e Shqipërisë ka filluar*)
- Sigurimi i një kuadri ligjor, institucional dhe politikave mbështetëse të vazhdueshme për thithjen dhe nxitjen e PPP-ve
- Sigurimi dhe forcimi i kapaciteteve të nevojshme të sektorit publik i nevojshëm për menaxhimin efektiv të projekteve koncesionare/PPP në të gjitha fazat.
- Asimetria e informacionit
- Zhvillimi i një tregu konkurrues me qëllim thithjen e investitorëve më të mirë.

Sugjerime

- ▶ Elementi kryesor I cili eshte nje nder faktoret vendimtar per percaktimin e vleres per para ne keto lloj projektesh eshte parimi I ndarjes efektive te riskut, parim I cili mendojme se duhet te jete nje nder elementet baze qe duhet te mbahet parasysh nga personat e ngarkuar gjate procedures se lidhjes se kontratave ne formen e PPP ne fushen e strehimit social, procedure e cila do te zbatohet ne baze te ligjit per strehimin social.
- ▶ Ajo qe do te sugjeronim te mbahet parasysh gjate nje procedure ne fushen e strehimit social, e cila mund te zbatohet qofte ne baze te ligjit per koncesionet dhe qofte ne baze te ligjit per strehimin social eshte qe personat e ngarkuar ne zbatimin e tyre duhet te kene njohuri te thelluara dhe nje experience te gjate ne fushe e PPP. Kjo me qellim hartimin e kontratave sa me mira, me detyrime te qarta dhe mekanizma perkates mbrojtës ne raport me risqet e identifikuar dhe alokuara.
- ▶ Gjithashtu, ajo qe do te sugjeronim qe per hartimin e ketyre draftkontratave te merreshin per baze aty ku eshte e mundur, draftkontratat me parashikime te standartizuara te cilat jane te publikuar ne faqen zyrtare te Bankes Boterore.
- ▶ Duke qene se keto kontrata mund te jene afatgjata, me qellim zbatimin efektiv te tyre dhe arritjen e nje output sa me cilesor do te sugjeronim percaktimin e klauzolave te forta monitoruese ne kontrate si dhe struktura adekuate per monitorimin e zbatimit te saj.

FALEMINDERIT !